



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KUKËS

Nr. 932/1 Prot

Kukës , më 06.11.2023

Lënda: “Njoftim mbi verifikimin paraprak të përmbushjes së kriterëve të kandidatëve me procedurën “Lëvizje Paralele” për pozicionin “Sekretare Gjyqësore”.

Drejtuar : KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
TIRANË

Bazuar në Ligjin 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Mbi lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, me anë të cilit janë përcaktuar rregulla të hollësishme për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësore, vendimit nr.147, datë 10.10.2023 të Këshillit të Gjykatës, shpalljes nr. 932 Prot, datë 20.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ju njoftoj:

Në përfundim të verifikimit paraprak, rezultuan të mos kemi kandidatë që i përmbushin kriteret në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin “Sekretare Gjyqësore”.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës do të vijojë me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për 3(Tre) pozicionet “Sekretare Gjyqësore”.

